



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2024:298684

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06486543

**PPP.nr.202/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen përmbartimore të kreditorit S.P., të cilin e përfaqëson Zahir Hamza avokat në Prishtinë, kundër debitorës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e borxhit në shumën prej 420.00 euro në emër të kompensimit për shujta ditore dhe shumën prej 228.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur me datë 06.09.2024 kundër urdhrit përmbartimor P.nr.7557/24 të datës 22.08.2024 i caktuar nga përmbartuesi privat Blerim Baloku me seli në Pejë, jashtë seancës gjyqësore me datë 21.11.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar** prapësimi i debitorit të përmbartimit, Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.7557/24 i datës 22.08.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat përmbartuesi privat Blerim Maloku me seli në Pejë **vetëm sa i përket shpenzimeve procedurale**, dhe atë i njihen kreditorit shpenzimet vetëm për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumën prej 117.00 euro, kurse **refuzohet** kërkesa për shpenzimet mbi shumën e aprovuar.
- II. MBETET NË FUQI** Urdhri për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.7557/24 i datës 22.08.2024, i lejuar nga Përmbartuesi privat Blerim Baloku me seli në Pejë, për shumën e borxhit kryesor në lartësi prej **420.00 euro** në emër të kompensimit për shujta ditore dhe shumës prej 228.00 euro për shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto të njohura sipas aktgjykimit C.nr.1098/22 të datës 16.07.2024.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e kreditorit për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim në shumën prej 156.00 euro

## A r s y e t i m

Përmbauesi privat Blerim Maloku me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit S.P. mësimdhënës në SHFMU "M." në L./Malishevë të cilin me autorizim e përfaqëson Zahir Hamza avokat nga Prishtina, ka lëshuar urdhrin numër P.nr.7557/24 të datës 22.08.2024 me të cilin e ka lejuar përmbauesin në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega e gjykatës në Malishevë/Divizioni Civil C.nr.1098/22 të datës 16.07.2024, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 02.08.2024, dhe i ekzekutueshëm me datë 12.08.2024.

Me propozimin për përmbauesin, kreditori ka kërkuar që të caktohet përmbauesi ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 420.00 € sipas aktgjykimit C.nr.1098/22 në emër të kompensimit për shujta ditore, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 228.00 euro, dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbauesin në shumën prej 156.00 euro.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbauesimit dhe brenda afatit ligjor me datë 06.09.2024, prapësim ka paraqitur debitori.

Në prapësim debitori ka theksuar se e konteston urdhrin për përmbauesin nga përmbauesi privat pasi kjo nuk është lejuar konform aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës C.nr.1098/22, pasi në bazë të këtij aktgjykimi, janë njohur shpenzimet e palës në procedurë në shumën prej 228.00 euro, ndërsa kreditori në propozim ka futur edhe shpenzimet kontestimore dhe përmbauesimore, pa e ndarë borxhin kryesor dhe kjo bëhet me qëllim të shkaktimit të shpenzimeve shtesë, sepse me urdhër përmbauesimor janë lejuar 228.00 euro shpenzime të procedurës kontestimore, ndërsa me aktgjykim këto janë aprovuar për dy paditës.

Përfaqësuesi i kreditorit i ka shtuar shpenzimet në përmbauesin dhe atë në shumën prej 156.00 euro, ndërsa sipas tarifës duhet të jenë 117.00 euro, sepse vlera e borxhit është 420.00 euro. Ka shtuar se duhet marrë parasysh edhe parimin e ekonomizimit të procedurës, dhe ka kërkuar që përmbauesimi të bëhet me një propozim në mënyrë që të mos lejohen shpenzime shtesë pasi kemi të bëjmë me çështje të njëjtë dhe mund të përmbauesohet me një urdhër përmbauesimor.

Andaj, i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin e komunës së Malishevës si të bazuar dhe urdhrin e përmbauesit privat Blerim Baloku ta shfuqizoj si të pabazuar sa i përket shpenzimeve procedurale që ka të bëjë lidhur me përmbauesimin si dhe të vlerësohen këto shkresa në bazë të konkluzionit të gjykatës së Apelit të Kosovës, lidhur me shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim me datë 04.10.2024 ka ushtruar i autorizuari i kreditorit i cili ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pabazuara, pasi vendimi i gjykatës C.nr.1098/22 është i formës së prerë, i ekzekutueshëm dhe i përshtatshëm për përmbauesim.

Sa i përket kundërshtimeve të debitorit për shpenzimet procedurale, këto shpenzime janë të përcaktuara qartë dhe atë 208.00 euro për përpilimin e padisë dhe 20.00 euro për taksë gjyqësore, e që në total janë 228.00 euro.

Andaj, i autorizuari i kreditorit ka kërkuar që gjykata të merr aktvendim me të cilin refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i pabazuar, të lejohet urdhri për përmbauesim

P.nr.7557/24 dhe të aprovohen shpenzimet procedurale për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 156.00 euro.

Vlerësimi i gjykatës dhe baza ligjore

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrit për përmbarim, prapësimi të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se:

-Prapësimi i debitorit është i pjesërisht i bazuar.

Gjykata nuk ka caktuar seancë gjyqësore, ngase të dhënat e parashtruara në propozimin për përmbarim si dhe dëshmitë e bashkangjitura, janë të mjaftueshme për të vendosur rreth kësaj çështje juridiko përmbarimore.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vendosur si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktvendimi ku e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit vetëm sa i përket shpenzimeve procedurale duke ia njohur shpenzimet kreditorit vetëm sa i përket përpilimit të propozimit për përmbarim në shumën prej 117.00 euro, ndërsa e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e kreditorit për kompensimin e shpenzimeve mbi shumën e aprovuar dhe atë për përpilimin e parashtrës në emër të përgjigjes në prapësim shumën prej 156.00 euro.

Lidhur me obligimin që debitori t'ia paguaj kreditorit shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumën prej 117.00 euro, gjykata është bazuar në rregulloren për tarifatat e avokatëve nr. tarifat 6 për përmbarim në bazë të titullit përmbarimor me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël (shuma deri 500.00 euro-për një kreditor).

Kurse refuzimi mbi shumën e aprovuar dhe atë për përgjigje në prapësim si në pikën - III- të dispozitivit, është refuzuar për shkak se e njëjta nuk konsiderohet parashtrës në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6.1 të OAK-së, si dhe nenit 2.4 të UA Nr.01/2017 të datës 15.03.2017, për unifikimin e taksave gjyqësore, si dhe pikës 4 të konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, e datës 16-17 mars dhe 26-27 qershor 2023.

Gjykata ka vendosur si në pikën -II- të dispozitivit duke e lënë në fuqi Urdhrin për lejimin e Përmbarimit numër P.nr.7557/24 të datës 22.08.2024 pasi gjeti se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar sa i përket shumës prej 420.00 euro për kompensimin e shujtave ditore, dhe shumës prej 228.00 euro për shpenzime të procedurës kontestimore, shuma këto të njohura sipas aktgjykimit C.nr.1098/22 të datës 16.07.2024, nga këto arsye:

Me nenin 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) është paraparë që: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përmbarim, sipas dokumentit përmbarimor dhe gjykata ka vlerësuar se përmbarimi i lejuar nga ana e Përmbaruesit

Privat bazohet në dokumentin përbarimor-aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë C.nr.1098/22 të datës 16.07.2024, i plotfuqishëm nga data 02.08.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 12.08.2024, në bazë të të cilit organi përbarues edhe e ka zbatuar përbarimin, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku përcaktohet se: *“Dokumentet përbaruese janë: 1.1. vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përbarues”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, Aktgjykimi në fjalë është dokument përbarues, i ekzekutueshëm dhe përbën bazë të ligjshme juridike për caktimin e përbarimit, ngase i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim ashtu siç e parasheh neni 24 par.1 i LPP-së, ku theksohet se: *“vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare”*, kurse në dispozitën e nenit 27 të LPP përcaktohet: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në anën tjetër, debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim, siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përbarimore (LPP), sipas të cilit: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Gjykata ka konstatuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, pasi kreditori propozimit për përbarim ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.1098/22 të datës 16.07.2024, i cili Aktgjykim është i plotfuqishëm nga data 02.08.2024, dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, e duke u bazuar në shkresat e lëndës, propozimi për përbarim i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së, pasi që propozimit për përbarim kreditori i ka bashkangjitur dokumentin me vulë të plotfuqishmërisë.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, Gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së.

Nga të cekurat më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të dispozitave të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

**Gjykata Themelore Gjakovë, Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil**  
**PPP.nr.202/24, datë 21.11.2024**

**Gjyqtari**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.